

**VENDIM**  
**Nr. 170, datë 17.3.2021**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.7, DATË 6.1.2020, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR KUSHTET DHE PROCEDURËN PËR SHPRONËSIMET**  
**DHE/OSE SHKËMBIMIN E PRONËS, PËR INTERES PUBLIK, NË FUNKSION**  
**TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 32, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pika 6, e kreut II, të vendimit nr.7, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Prona private, njësi tregtimi:

a) pronarët privatë, që kanë në pronësi njësi tregtimi në zonën e re për zhvillim, kompensohen me vlerë në masën që përlogaritet nga komisioni i shpronësimit, duke iu referuar çmimeve që zbatohen në procedurat për shpronësimin, për interes publik, sipas legjislacionit në fuqi; ose

b) me pëlqimin e tyre, pronarët privatë që kanë në pronësi njësi tregtimi në zonën e re për zhvillim, kompensohen nëpërmjet shkëmbimit të Së drejtës së pronësisë mbi njësinë e tregtimit me fitimin e pronësisë mbi një njësi banimi ose njësi tregtimi, nëse ka, me të njëjtën sipërfaqe në metër katror sa njësia e tregtimit që kishin në pronësi;

c) në rast se, për shkak të strukturës së njësisë së tregtimit, njësisë së banimit ose shtëpisë individuale të banimit në zonën e re, rezultojnë sipërfaqe shtesë në pronën me të cilën kompensohet, pronari privat paguan për çdo metër katror shtesë çmimin e miratuar me vendim nga Enti Kombëtar i Banesave në fuqi në kohën e shpronësimit ose të shkëmbimit. Në rast se, për shkak të strukturës së njësisë së tregtimit, njësisë së banimit ose shtëpisë individuale të banimit në zonën e re rezultojnë sipërfaqe më të vogla, në pronën me të cilën kompensohet, pronari privat ka të drejtë të kompensohet, për pjesën e mbetur të sipërfaqes, në përputhje me shkronjën “a”, të kësaj pike.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ministri i Shtetit për Rindërtimin, njësitet e vetëqeverisjes vendore, njësitet zbatuese dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**